

VENDIM
Nr.18, datë 13.1.1997

**PËR PROKURIMIN ME FONDE SHTETËRORE PËR PRODHIMIN E KALEMAVE
TË KULTIVARËVE AUTOKTONË TË VRESHTARISË**

(Ndryshuar me vendimin nr. 85, datë 24.2.1997)

(I përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, neni 17 pika 3, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit që, nëpërmjet Institutit të Pemëtarisë në Vlorë, të prokurojë drejtpërdrejt shumën prej 7 milionë lekësh për grumbullimin dhe përgatitjen e kalemave nga kultivarët autoktonë të vreshtarisë shqiptare.

1/a. Për fazën e parë të emergjencës për vreshtarinë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit i shtohen 7 milionë lekë që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave i parashikuar për 3-mujorin e parë të vitit 1997.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi